



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	13.07.2021
Referenc-ë:	07-353/04-133987/21
Për/ Za/ To:	Lëvizja VETËVENDOSJE
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokoli 07-353/04-133987/21 nga Lëvizja VETËVENDOSJE me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në parkun e qytetit me datë 22 dhe 23 Korrik 2021 nga ora 17:00 deri në 22:00.

Qëllimi i kërkesës është organizimi i një pikniku për mërgatën.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin Lëvizjes VETËVENDOSJE për shfrytëzimin e hapësirës publike në parkun e qytetit me datë 22 dhe 23 Korrik 2021 nga ora 17:00 deri në 22:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e më parshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.